

VENDIM
Nr.714, datë 20.10.2011

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E PUNËVE
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË SIPËRFAQES 46 266 M²,
NË ZONËN KADASTRALE NR.8340, ME NUMËR PASURIE 8/76, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR.120, DATË 4.3.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit te Ministria e Drejtësisë, të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², në zonën kadastrale nr.8340, me numër pasurie 8/76, me emërtim “Stacion hekurudhor, Tiranë”, e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë.

2. Sipërfaqja 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ndalohen tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha